



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:254317

Datë: 22.10.2020

Numri i dokumentit: 01211904

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.1014/19

GJYKATA THEMELORE NE PEJE – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, sipas Gjyqtarit Murat Hulaj, me pjesëmarrjen e praktikantes Edita Ferati, në lëndën penale kundër të pandehurit P. B. nga fsh. Llabjan, K. Pejë i akuzuar për vepër penale, *legalizim i përmbajtjes se rreme*, parashikuar nga neni 395 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1822/19 të datës 01.11.2019, në seancën publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur me 28.09.2020, në praninë e Prokurorit të Shtetit Dorjan Juniku dhe te pandehurit P. B., të njëjtën dite mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt. 21.10.2020, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari,

P. B., i lindur me ne fsh., me adrese te banimit ne fsh.K. Pejë, i biri i S. dhe nënës Xh., e gjinisë G., ka te kryer fakultetin e biznesit, me profesion kamarier, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, i martuar, baba i dy fëmijëve, identifikohet me nr. personal, shtetas i Republikës se Kosovës, posedon nr. tel., i pa gjykuar më parë, mbrohet ne liri.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

- Qe nga viti 2011 gjer me datën 11.06.2017, me dije përdor dokumentin edhe pse e di qe është i rreme, dhe atë karrocerinë e automjetit te markës ngjyre e kuqe, viti i prodhimit 1986, me numer te shasisë, me date të panjohur ka manipuluar numrin e karrocervisë ne veturën e lartcekur ku është lyer me ngjyre, e këtë me qellim te përdorimit te automjetit me nr. te karrocervisë si te vërtete edhe pse e ka ditur se numri i shasisë është i rreme,

Me çka ka kryer veprën penale, *legalizim i përmbajtjes se rreme*, parashikuar nga neni 395 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së

Andaj, gjykata komfor nenit 2, 7, 8, 9, 10 par.1, 17 par.1, 21, 41, 42, par.1 nëpar.1.1, 43 par.1 në par.1.2, 47, 62, 64 dhe nenit 395 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe neneve 245,246,247,248 par.1,4, 359, 360, 361, 365, 366, 453 par.4 dhe 463 par.2, të KPPRK-se, të pandehurin e:

G J Y K O N

-Me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë) ditësh.

-Dënimi me burg, me pëlqimin e të akuzuarit, i zëvendësohet me dënim gjobe në të holla në shumë prej 300 (treqind) euro.

-Dënimi me gjobë duhet të ekzekutohet në afat prej 90(nëndëdhjet) ditësh, e nëse i akuzuari nuk e ekzekuton dënimin me gjobë apo e refuzon ekzekutimin, atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet me burgë, e duke llogaritur 20 (njëzet)euro për një ditë burgimi .

-I akuzuari detyrohet që Gjykatës në emër të shpenzimeve të procedurës penale të ja paguan shumën prej 20 (njëzet) euro, në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 15 (pesëmbëdhjetë) euro, dhe në emër të kompensimit të viktimave shumën prej 30 (tridhjetë) euro.

-Palët eventuale të dëmtuara që mund të paraqiten për kërkesën pasurore-juridike, udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Dënimi plotësues,

-*Urdhërohet konfiskimi* i mjetit i tipit, viti i prodhimit 1986, ngjyre kuqe me targa, me nr. te karrocërisë, që është sekuestruar sipas urdhrorit te gjyqtarit te procedurës paraprake me nr. UGJK.nr..... i dt. 18.06.2019.

-Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi të merre formën e prerë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, ka ngrit aktakuzën PP.II.nr.1822/19 të datës 01.11.2019, ndaj te pandehurit P. B., për vepër penale, legalizim i përmbajtjes se rreme, parashikuar nga neni 395 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1822/19 të dates 01.11.2019.

Gjykata, mbajti shqyrtimin fillestar, me datë 28.09.2020, ne praninë e Prokurorit të Shtetit Dorjan Juniku dhe të pandehurit P. B. nga Peja, në të cilën seancë i pandehuri pasi që u njoftua me të drejtat e tij, me aktakuzën dhe provat kundër tij dhe pasi që Prokurori i Shtetit lexoi aktakuzën, i akuzuari deklaroi se e ka kuptuar aktakuzën dhe se nuk ka nevojë për sqarime

shtesë për veprën që e ngarkon akuza, u deklaroi se e pranonte fajësinë, për veprën penale për të cilën akuzohet. Shprehi keqardhjen e tij dhe deklaroi se palën e dëmtuar e ka kompensuar në shumë prej 1000 (njëmijë) euro.

Gjykata paraprakisht të pandehurit i ka sqaruar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë dhe e ka udhëzuar se me pranimin e fajësisë i njëjti do të shpallet fajtor për veprat penale të lartcekura, do të shqiptohet sanksioni i parapare me ligj, dhe se nuk do të ketë procedurë të provave.

Pas deklarimit se i pandehuri pranoi fajësinë, mendimit të prokurorit i cili nuk e kundërshtoi pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, Gjykata konstatoi se i pandehuri e pranoi fajësinë në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë presion. I pandehuri P. B. është i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë, si dhe të gjitha kërkesat nga neni 248 par. 1, të KPPRK-se, janë përmbushur. Andaj, gjykata aprovoj pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Gjykata ka vërtetuar faktet të paraqitura në aktakuzë nga pranimi i fajësisë që e ka bërë i pandehuri i cili ka pasur të njohur natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, në mënyrë vullnetare, me vetëdije, pa ndonjë detyrim, mashtrim apo lajthim e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihen në barre, e i cili pranim mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuzën, në materialet e prezantuara nga Prokurori i Shtetit, dhe se aktakuzën nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Duke pas parasysh se gjykata, ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe duke u ndërlidhur me atë se, ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 253 par. 1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 248 par 4, të KPPRK-së, atëherë, në këtë çështje penale, nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të pandehurit se e pranonte fajësinë ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me faktet e ofruara në shkresat e lëndës Raporti informues me nr. të rastit 2019-DI-20 i dt. 18.06.2019; Raporti i oficerit Fatmir Muqolli, date 17.06.2019; Procesverbali i marrjes në pyetje në polici, të Arbnor Lokaj, dt. 13.06.2019; Kallëzimi penal, nr. 2019-DA-20, date 16.08.2019; Njoftimi i Qendrës së Automjeteve të Kosovës, për refuzim të kërkesës për procedurë të ndërrimit të automjetit, date 17.05.2019 prej 8 faqesh; Email komunikimi, date 15.08.2019; Formulari i konfiskimit të veturës, librezës së qarkullimit dhe të çelësave të veturës, date 14.06.2019; Kontrate për shitblerjen e veturës, LRP nr. rend 5143/2017, date 11.06.2017 lidhur mes shitësit P. B. dhe blerësit Arbnor Lokaj; Urdhër për Ekspertizë të Numrit të Karrocërisë drejtuar Agjencionit Kosovë për Forenzike në Prishtinë, date 16.07.2019; Plotësimi i Kallëzimit Penal nr. 2019-DA-20, date 17.09.2019; Raporti i Ekspertizës së Agjencionit të Kosovës për Forenzike, date 13.08.2019; nr. AKF/2019-1922/2019-1704, Kërkesa për sekuestrim të përkohshëm, PPN.IL nr. 529/2019, date 18.06.2019; Urdhëri i Gjykatës Themelore në Pejë, Nr. UGJK për Sekuestrim të Përkohshëm të Sendëve, të veturës, date 18.06.2019; Kërkesën për Urdhër të Përkohshëm të Sigurisë të sendëve të sekuestruara përkohësisht, date 16.08.2019; Urdhër për Masë të Përkohshëm të sigurisë të veturës, Gjykata Themelore në Pejë, date 19.08.2019, UGJK nr. 110/19; Aktvendimi për Fillimin e hetimeve, date 16.08.2019; PP.IL.nr. 1822/2019; Procesverbali i marrjes në pyetje të A. L., date 01.08.2019; Libreza e qarkullimit dhe shkresat e tjera e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, Gjykata ka konstatuar se i pandehuri i cili ka pasur të njohur natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, në mënyrë vullnetare, me vetëdije, pa ndonjë detyrim, mashtrim apo lajthim e ka pranuar fajësinë për veprat penale të cilat i vihen në barre, i cili pranim mbështetet në faktet e çështjes që përmban

aktakuza, ne materialet e prezantuara nga Prokurori i Shtetit, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike. Duke pasur parasysh te gjitha këto fakte rrjedh konstatimi se në veprimet e të pandehurit P. B. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale, *legalizim i përmbajtjes se rreme*, parashikuar nga neni 395 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë, gjykata ka gjetur se te i pandehuri ka ekzistuar dashja që veprën penale ta kryen në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit pasi që i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për veprën e kryer. Gjatë procedurës penale, nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të pandehurit kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin gjykata ka vlerësuar faktin se i njëjti e bëri pranimin e fajësisë ne mënyrë vullnetare, pa presion dhe ndikim, shprehi keqardhjen e tij për atë çfarë ka ndodhur dhe u betua qe me nuk do te ndodhë dhe deklaroi se palën e dëmtuar e ka kompensuar ne shume prej 1000 (njëmijë) euro. Rrethana rënduese gjykata nuk gjeti.

Andaj, duke vlerësuar këto rrethana, Gjukata ne kuptim te nenit 69 te KPRK-se të pandehurin e gjykoi si ne dispozitiv te këtij aktgjykimit, me te cilin do te arrihet edhe qëllimi i dënimit. Gjukata ka ardhur ne përfundim se dënimi i shqiptuar të pandehurit është ne përputhje me shkallen e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit te vlerave te mbrojtura te shoqërisë.

Gjukata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do te shërbej për arritjen e qëllimit te dënimit ne pengimin e të pandehurve ne kryerjen e veprave penale ne të ardhmen, por ai do te ndikoj edhe si preventive e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale në përputhje me nenin 38 te KPPRK-se.

Duke u bazuar ne nenin 450 par. 1, 2 pika 2.6 të KPPRK-se, gjykata ka përcaktuar shpenzimet procedurale penale në shumë prej 20 (njëzet) euro dhe ne emër te paushallit gjyqësor shumë prej 15 (pesëmbëdhjetë) euro duke u bazuar ne shpenzimet qe janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri ne përfundimin e saj, përderisa,

Vendimi për kompensimin e viktimave te krimit, secilit veç e veç ne shumen prej 30 (tridhjetë) euro, gjykata e mori në përputhje me nenin 39, par.1,2,3, nën par. 3.1, të Ligjit për kompensim të viktimave të krimit, duke e obliguar të akuzuarin që ti paguaj shpenzimet e viktimave të krimit.

Vendimi për udhëzimin e palëve eventuale të dëmtuara qe munden të paraqesin kërkesën pasurore juridike ta realizojnë ne kontest civil u morr në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Vendimin mbi dënimin plotësues, të sendeve qe ishin rezultat i veprës penale, gjykata e mori në përputhje me nenin 284 par.1 dhe 2 të KPPRK-ës.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 370 të KPPRK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË,
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.1014/19 më datë 16.10.2020**

Praktikante,

Gjyqtari Gjykues,

Edita Ferati

Dr.sc. Murat Hulaj

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejtë të parashetrojnë ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.